

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BREGU LOFATAVE" SH.P.K

Neni 1
Emërtimi i shoqerise

So me date 12/08/2021 hartohet ku akt themelimi nga ortakët Znj.Jonida Micaj i datelindjes 08 Mars 1985 me id I55308097H dhe Z.Florian Shytaj i datelindjes 12 Janar 1977 me id H70112032W i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "BREGU LOFATAVE" shpk
Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008" Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 2
Selia e shoqerise

Selia e shoqërisë "BREGU LOFATAVE" shpk është lagja Pavarsia,Rruga Ismail Qemali ,objekti nr.29/212-N9, kati 1,Vlore.
Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjisllacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3
Kohëzgjatja e veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete subjekt i te drejtes shqiptare deri me 12.08.2031. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut te shoqerise.

Neni 4
Objekti

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë si vijon :

Aktivitetet në fushën e kultivimit të ullirit, prodhimin dhe shitjen e vajit të ullirit extra virgin, eksportin e vajit të ullirit extra virgin dhe eksportin e produkteve agro-ushqimore.

Neni 5
Kapitali i regjistruar

Vlera e kapitalit të kontribuar dhe të regjistruar në shoqëri është 100.000 leke (njëqindmijë) , numri i kuotave është 2 (dy) Pjesëmarrja në përqindje është 60% (me vlerë 60,000 leke) nga znj.Jonida Micaj e cila zoteron 1 kuotë dhe 40% (me vlerë 40,000 leke) nga z.Florian Shytaj i cili zoteron 1 kuotë

Kapitali zotërohet 60% nga Ortaku i shoqërisë Znj.Jonida Micaj dhe 40% nga ortaku z.Florian Shytaj.

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë .

Neni 6

Drejtimi dhe administrimi

Organet drejtuese të shoqërisë janë :
Asambleja e përgjithshme e shoqërisë
Administratori i shoqërisë

Shoqëria administrohet prej një Administratori të vetëm. Administratori i shoqërisë do të jetë ortaku Z.Jonida Micaj me ID I55308097H me një afat 5 vjeçar

Vlorë më , 12 Gusht 2021

ORTAKET E SHOQËRISË

Znj.Jonida Micaj



Z.Florian Shytaj

